

A JENI I ZHVENDOSUR?

A KENI NEVOJË PËR MBËSHTETJE PËR KTHIM DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME?

Rregullorja 01/2018 e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) mbi Kthimin dhe Zgjidhje të Qëndrueshme të miratuar më 2018, rregullon zgjidhjet e qëndrueshme për të kthyerit dhe personat e zhvendosur, mekanizmat dhe mundësitë e asistencës.

Personi duhet të jetë i zhvendosur si pasojë e konfliktit midis 28 shkurtit 1998 dhe 31 marsit 2004.

Rregullorja siguron mos-diskriminim gjatë gjithë procesit të kthimit dhe riintegrit të personave të zhvendosur.

SI DHE KU TË APLIKONI PËR MBËSHTETJE PËR KTHIM DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME?

Si: Ju duhet të plotësoni formularin e aplikimit për ndihmë. Formulari i aplikimit është në dispozicion në faqen e internetit të MKK-së (Shtojca 1). Pas plotësimit të formularit të aplikimit ju duhet ta nënshkruani atë.

Ku: Nëse jeni i zhvendosur brenda Kosovës ose i kthyer pa ndonjë zgjidhje të qëndrueshme ju duhet ta dorëzoni aplikacionin në ZKKK në komunën ku dëshironi të siguronit zgjidhje të qëndrueshme.

Nëse jeni i zhvendosur në Serbi, Maqedoni ose Mal të Zi ju duhet të dorëzoni kërkesën tuaj të nënshkruar tek autoritetet përgjegjëse për të zhvendosurit nga Kosova.

Aplikimi në internet: Sapo Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) të krijojë mundësinë e aplikimit në internet, ju mund të aplikoni në internet. **Vini re** se duhet të nënshkruani kërkesën tuaj të dorëzuar në internet brenda 15 ditëve pas dorëzimit, në mënyrë që ajo të procesohet nga ZKKK.

ÇFARË NDODH ME APLIKACIONIN TUAJ?

Komisioni Komunal për Kthim do të shqyrtojë aplikacionin tuaj dhe do të rekomandojë aplikuesit e

kualifikuar për ndihmë tek **Komisioni Qendror i Shqyrtimit** në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Komisioni Qendror i Shqyrtimit do të sjellë vendimin përfundimtar për ndihmë për secilin aplikues.

I tërë procesi pritët të zgjasë jo më shumë se tridhjetë e pesë (35) ditë pune.

E DREJTA PËR ANKESË

Në rast se kërkesa juaj për ndihmë të kthimit është refuzuar nga Komisioni Qendror i Shqyrtimit, ju keni të drejtë të ankoheni përmes Komisionit të Ankesave. Ankesa paraqitet përmes Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në komunën tuaj brenda tridhjetë (30) ditëve të punës.

NDIHMA

Rregullorja parasheh ndihmën që mund të ju ofrohet në varësi të nevojave tuaja dhe nivelit të cenusshmërisë, si dhe nëse i plotësoni kriteret.

- **Transport falas** dhe lirim nga dogana për gjësendet.
- **Strehim i përkohshëm/Banim social** përmes skemës së qirasë për 3-12 muaj, për të kthyerit tepër të cenushtëm.
- Pas skadimit të afatit të akomodimit, komunitat përkatëse sipas ligjit, do të sigurojnë strehim përmes **banimit social**, nëse është i disponueshëm.
- **Ndihma për banim:** Komisioni qendror do të sjellë një vendim mbi:
 - **Renovimin**, ose
 - **Ndërtimin e shtëpisë**

Madhësia e shtëpisë varet nga madhësia e familjes: 45 m² për familje deri në 4 anëtarë; 55 m² deri në 6 anëtarë; 62m² deri në 7 anëtarë; 75m² deri në 9 anëtarë; 95m² deri në 10 anëtarë dhe familjet me mbi 10 anëtarë do të përfitojnë shtëpi me dizajn të veçantë. Tarifat për kyçje në rrjetin elektrik, ujë dhe kanalizim janë falas dhe përfshihen në projektin e ndërtimit të shtëpive.

- **Pako ushqimore** 3-mujore.
- Artikuj jo-ushqimor: **batanije, enë/komplete kuzhine, pako higjienike.**
- **Mobilje:** lavaman kuzhine, dollap kuzhine, divan, shtretër gjumi, tavolinë për ngrënie, karrige (deri në 6), dollapë dhome gjumi, dollap për TV.
- **Pajisjet shtëpiake:** stufë për shumë qëllime, frigorifer, stufë elektrike, makinë larëse,
- **Dru për ngrohje.**

Familjet pa pronë mund të aplikojnë në Komunë për **ndarje të tokës.**

SI MUND TË GJENEROJ TË ARDHURA

Ju keni të drejtë të regjistrohni në zyrën e punësimit në komunën tuaj. ZKKK mund t'ju ndihmojë në proces sipas nevojës.

Nëse keni nevojë dhe interesim të fitoni aftësi për cilindo profesion, ju mund të përfitoni nga Trajnimi Profesional pa pagesë në dispozicion. ZKKK mund të ju ndihmojë.

Nëse keni një ide biznesi dhe mundësi për ta zhvilluar atë, ju mund të përfitoni nga projektet e disponueshme dhe/ose projektet e vetë-mbështetjes.

TË DREJTAT DHE SHËRBIMET

Nëse keni nevojë për dokumente personale, kontaktoni Zyrat e Gjendjes civile në komunën tuaj. ZKKK do të ndihmojë.

Nëse keni vështirësi në marrjen e dokumenteve personale, ndihma juridike është në dispozicion. ZKKK do të ju ndihmojë të lidheni me ofruesit e ndihmës.

Fëmijët tuaj mund të kenë qasje në arsim në të gjitha nivelet. Nëse keni nevojë për ndihmë, ZKKK mund të ndihmojë. Nëse keni nevojë të validoni certifikatat e shkollës nga shkolla e mëparshme, ju mund ta bëni lehtë këtë gjë.

Shërbimet mjekësore janë në dispozicion në qendrën më të afërt të kujdesit parësor shëndetësor në Komunën tuaj.

Shërbimet mjekësore dytësore janë në dispozicion në çdo komunë më të madhe në mbarë Kosovën.

Nëse familja juaj i plotëson kriteret e ndihmës sociale ju do të përfitoni nga kjo. ZKKK mund të ju ndërlidhë me Qendrën për mirëqenie sociale.

Nëse jeni 65 vjeç ose më i vjetër dhe nuk merrni ndonjë pension ju keni të drejtë të përfitoni nga skema pensionale e Kosovës.

TË DREJTAT TUAJA PRONËSORE

Qasja në prona dhe të drejtat pronësore janë të garantuara me kornizën ligjore.

Në rast se keni nevojë për mbështetje ju mund të kontaktoni AKKVP-në dhe/ose gjykatën.

Nëse keni nevojë për ndihmë juridike për çështjen tuaj pronësore, ZKKK do t'ju lidhë me ofruesit e ndihmës juridike.

Me ligj ju jeni të liruar nga tatimi në pronë gjatë kohës sa jeni i zhvendosur (Ligji 06/L-005, Neni 39). ZKKK mund të ju mbështesë në këtë.

Borxhet e grumbulluara në shërbimet publike janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2017 Neni 3. ZKKK mund të ju ndihmojë të lidheni me kompanitë publike për këtë çështje.

MBANI NË MEND!

Kur të ktheheni, për të mundësuar integrimin tuaj më të lehtë, keni parasysh që të keni me vete dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatat e arsimit/diplomat, për arsimin e përfunduar
- Dokumentacioni i lëshuar nga institucionet e specializuara për anëtarët me probleme shëndetësore dhe me aftësi të kufizuara
- Certifikata e përvojës së punës dhe/ose trajnimit profesional



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Kjo fletëpalosje është prodhuar nga
Ministria për komunitete dhe kthim
në janar të vitit 2019

Më shumë informata

Për më shumë informata në lidhje me kthimin

Faqja e internetit e MKK: <http://mzp-rks.org/>
Komunat: www.kk.rks-gov.net

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

*Kjo fletëpalosje përmban informata bazë
mbi Kthimin dhe Riintegrimin e PZh-ve dhe
PZhB-ve në Republikën e Kosovës*